

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-4299/1 datë 17.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/3 datë 24.10.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 40-të mbajtur më 24.10.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për vërejtje publike dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimit programor

1. **PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion, tregti dhe shërbime DRIM SAT IPTV SHPKNJP eksport-import fsh. Çergan- Gostivar, sepse ka ritransmetuar shërbim programor që nuk është i regjistruar në Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4299/1 datë 17.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. **URDHËROHET** që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion, tregti dhe shërbime DRIM SAT IPTV SHPKNJP eksport-import fsh. Çergan-Gostivar, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, gjegjësisht të përjashtom ritransmetimin e shërbimit programor.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe përjashtimin e ritransmetimit të shërbimit programor.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit pra vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar, Agjencia në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV ose të dispozitave të miratura në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të pakos programore që ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij Ligji, lejet, vërtetimeve të dhëna për regjistrim, akte nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më 17.10.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të pakos

programore të ritransmetuar nga ana e operatorit Shoqërisë për telekomunikacion, tregti dhe shërbime DRIM SAT IPTV SHPKNJP eksport-import fsh.Çergan-Gostivar, ku është konstatuar se operatori në fjalë që sipas notifikacionit të Agjencisë për komunikime elektronike ka të drejtë të ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 17.10.2024 për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, që nuk përfshihet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë detajisht të specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4299/1 datë 17.10.2024 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-4299/1 datë 17.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4359/3 datë 24.10.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV cekur në pikën 1. Të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendimin ku ndaj subjektit të mësipërm të ndërmirret masë vërejtje publike dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që do të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia të kryej mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti në fjalë veproi sipas urdhëresës, gjegjësisht sipas vërejtjes publike dhe ka ndërprerë me ritransmetim të shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për paraqitje të padisë për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa mësipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-4299/1 datë 17.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.